

VENDIM
Nr. 22, datë 25.1.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 183, DATË 13.11.2020, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GREENTECH ENERGY
SYSTEMS’ SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 64, pika 2 dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/2 prot., datë 19.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155 prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/35 prot., datë 16.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoj plotësimin e dokumentacionit të munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se shkresa e ERE-s nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020 (kërkesë e bërë përpara përfundimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s), është dërguar në adresën qendrore të shoqërisë, në Poroçan, dhe personi që e ka marrë në dorëzim, duke qenë i infektuar me COVID-19, nuk ia ka dorëzuar në kohë, çka ka bërë që shoqëria të mos ketë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 21.12.2020, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo vendimmarrje iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 1155/3 prot., datë 23.12.2020.

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3 prot., datë 6.1.2021, ka bërë me dije se: “për sa i përket aplikimit për licencë për tregtim të energjisë elektrike heqim dorë për momentin”.

- Neni 64, i “Kodit të Procedurave Administrative”, në pikën 2 parashikon se:

“- Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

- Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti